

### Përmbledhje

Aktiviteti ekonomik në eurozonë ka vazhduar rritjen e përshpejtuar edhe në TM2 2017. Po ashtu, shkalla e inflacionit në eurozonë ka shënuar rritje, ndikuar kryesisht nga politika e lehtësuar monetare në eurozonë dhe rritja e çmimeve të energjisë, shërbimeve dhe të ushqimit.

Lehtësimi i kushteve të financimit, si rezultat i politikave ekspansioniste dhe masave jokonvencionale të ndërmarra nga BQE, si dhe përmirësimi i kërkesës së brendshme kanë mbështetur aktivitetin ekonomik në eurozonë. Përforcimi i kërkesës në eurozonë është reflektuar pozitivisht në zhvillimet ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilat u karakterizuan me rritje të eksporteve, investimeve si dhe konsumit.

Rritja e aktivitetit ekonomik në Kosovë gjatë gjysmës së parë të vitit 2017 është mbështetur nga përforcimi i kërkesës së brendshme, gjegjësisht nga rritja e konsumit dhe investimeve por edhe nga rritja e eksportit të mallrave dhe shërbimeve. Sipas vlerësimeve të ASK-së, ekonomia e Kosovës është karakterizuar me një rritje të BPV-së reale prej 3.9 përqind në TM1 2017, ndërkohë që vlerësimet preliminare të BQK-së sugjerojnë për një rritje edhe më të lartë të BPV-së reale në TM2 2017. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2017, indeksi i çmimeve të konsumit në Kosovë është karakterizuar me rritje mesatare prej 1.7 përqind.

Spektori fiskal u karakterizua me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore prej 4.1 përqind deri në 6.9 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi bilanc primar buxhetor prej 2.8 milionë euro, krahasuar me bilancin prej 21.6 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2016.

Deficitit i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ishte më i ulët për 3.9 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ky përmirësim i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale i atribuohet kryesisht rritjes më të theksuar të eksportit të mallrave dhe shërbimeve (11.6 përqind) krahasuar me rritjen e importit të mallrave dhe shërbimeve (5.2 përqind). Përveç eksportit të mallrave dhe shërbimeve, me rritje janë

karakterizuar edhe të ardhurat parësore dhe dytësore (22.1 përqind deri në 4.6 përqind).

Në kuadër të llogarisë financiare, investimet e huaja direkte gjatë gjysmës së parë të vitit 2017 kanë shënuar rritje prej 64.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016.

Deri në TM2 2017, sektori bankar u karakterizua me rritje të përshpejtuar të aktivitetit kreditues (10.0 përqind), kryesisht si rezultat i lehtësimit të kushteve të kreditimit nga ana e bankave dhe rritjes së kërkesës për kredi. Rritja e kreditimit vazhdon të financohet qëndrueshëm nga depozitat e mbledhura brenda ekonomisë së vendit, të cilat në këtë periudhë shënuan një rritje vjetore prej 7.2 përqind.

Norma mesatare e interesit në kredi në qershor 2017 u zvogëluar në 6.8 përqind, përderisa norma mesatare e interesit në depozita shënoi rritje të lehtë në 1.1 përqind.

Norma e kredive joperformuese vazhdoi të përcjellë trend rënës, duke zbritur në 3.9 përqind deri në qershor 2017, përderisa edhe treguesit tjerë të shëndetit financiar vazhduan të qëndrojnë në nivele të kënaqshme.

Me rritje të aktivitetit u karakterizuan edhe segmentet tjera të sistemit financiar, si sektori pensional, sektori i sigurimeve dhe sektori mikrofinanciar. Për sa i përket performancës, sektori pensional realizoi kthim nga investimet dukshëm më të lartë se periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Po ashtu, edhe sektori mikrofinanciar dhe sektori i sigurimeve u karakterizuan me rritje të profitit në qershor 2017 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE</b> -----	<b>i</b>
<b>Eurozona dhe Ballkani Perëndimor</b> -----	<b>05</b>
<b>Ekonomia e Kosovës</b> -----	<b>07</b>
Sektori Real-----	07
Regjistri i bizneseve -----	08
Sektori Fiskal-----	09
Sektori i Jashtëm -----	10
Sistemi Financiar-----	12
Sektori Bankar -----	12
Sektori Pensional-----	20
Sektori i Sigurimeve -----	21
Sektori Mikrofinanciar -----	22
Tregu i Letrave me Vlerë -----	25

## GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Rritja vjetore e BPV-së në eurozonë-----	05
Figura 2. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së-----	06
Figura 3. Norma e inflacionit-----	07
Figura 4. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë -----	07
Figura 5. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit-----	08
Figura 6. Lëvizja e çmimeve të importit -----	08
Figura 7. Lëvizja e çmimeve të prodhimit-----	08
Figura 8. Regjistri i bizneseve-----	09
Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja -----	09
Figura 10. Eksporti dhe importi i mallrave-----	10
Figura 11. Struktura e eksporteve sipas kategorive-----	10
Figura 12. Struktura e importeve sipas kategorive -----	11
Figura 13. Remitencat-----	11
Figura 14. Struktura e investimeve të huaja direkte-----	12
Figura 15. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës -----	12
Figura 16. Struktura e aseteve të sektorit bankar -----	13
Figura 17. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave -----	13

Figura 18. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare-----	14
Figura 19. Kreditë sipas sektorëve ekonomik -----	14
Figura 20. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik -----	14
Figura 21. Depozitat -----	15
Figura 22. Struktura e depozitave -----	16
Figura 23. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita -----	16
Figura 24. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve-----	16
Figura 25. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	17
Figura 26. Norma mesatare e interesit në depozita -----	17
Figura 27. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje -----	17
Figura 28. Norma mesatare e interesit në depozitat për ekonomitë familjare -----	17
Figura 29. Profiti neto i sektorit bankar-----	18
Figura 30. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar -----	18
Figura 31. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	19
Figura 32. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve -----	19
Figura 33. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës -----	19
Figura 34. Asetet e sektorit pensional -----	20
Figura 35. Investimet e FKPK-së -----	20
Figura 36. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	21
Figura 37. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	21
Figura 38. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	21
Figura 39. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve, rritja vjetore e kredive-----	23
Figura 40. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve -----	23
Figura 41. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar-----	23
Figura 42. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	23
Figura 43. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	24
Figura 44. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	24
Figura 45. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar-----	24
Figura 46. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore -----	24
Figura 47. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	25
Figura 48. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit-----	25
Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së -----	07
Tabela 2. Numri dhe vlera e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës -----	25
Tabela 3. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	27

**SHKURTESAT:**

APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CHF	Franku Zvicërran
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit
KJP	Kreditë Jopërfomuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
USD	Dollari Amerikan
WEO	World Economic Outlook

## Eurozona dhe Ballkani Perëndimor


Gjatë TM2 2017, eurozona e vazhdoi rritjen e përshpejtuar të aktivitetit ekonomik. Përforcimi i mëtejshëm i kërkesës së brendshme në eurozonë, si dhe rritja e besimit të konsumatorëve dhe bizneseve pas zgjedhjeve në Holandë, Austri dhe Francë u reflektuan pozitivisht në aktivitetin ekonomik të eurozonës. Për më tepër, politikat ekspansioniste dhe masat jokonvencionale të ndërmarra nga BQE në kuadër të programit të lehtësimit sasior lehtësuan dukshëm kushtet e financimit në eurozonë, duke mbështetur kështu zgjerimin e aktivitetit ekonomik. Krahasuar me periudhën e njëjte të vitit paraprak, në TM2 2017, ekonomia e eurozonës shënoi rritje prej 2.2 përqind. Ndërsa, krahasuar me tremujorin paraprak, eurozona u karakterizua me rritje të BPV-së prej 0.6 përqind. Rritja e vlerës së shtuar në BPV, sidomos nga sektorët e prodhimit, veçanërisht në Gjermani dhe Francë, u reflektua pozitivisht në rritjen e përgjithshme reale të BPV-së në eurozonë. Në vitin 2017, BQE ka parashikuar një rritje reale të BPV-së prej 1.9 përqind, mbështetur kryesisht në përforcimin e eksporteve të eurozonës dhe politikën e lehtësuar monetare. Rritja ekonomike në TM2 2017 mbeti e koncentruar në ekonomitë qendrore të eurozonës si Gjermani (2.1 përqind), Francë (1.8 përqind), Holandë (3.8 përqind), Itali (1.5 përqind) dhe Spanjë (3.1 përqind).

Në qershor 2017, norma e inflacionit arriti në 1.3 përqind, për dallim nga periudha e njëjte e vitit paraprak kur ishte 0.1 përqind.

Politika e lehtësuar monetare dhe rritja e çmimeve në kategoritë kryesore si energjia, shërbimet dhe

ushqimi janë reflektuar në rritje të theksuar të shkallës së inflacionit në periudhën raportuese.

Figura 1. Rritja vjetore e BPV-së në eurozonë




Burimi: Eurostat (2017)

Për vitin 2017, sipas parashikimeve të BQE-së, shkalla e inflacionit në eurozonë pritet të jetë 1.5 përqind. Lansimi i programit të gjerë stimulues që nga marsi i vitit 2016 është reflektuar në rënien e normës 1 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor. Gjithashtu, në TM2 2017, norma 12 mujore e interesit të kreditimit ndërbankar në eurozonë u karakterizua me rënie. BQE-ja vazhdoi të mbajë normën e interesit në operacionet kryesore të rifinancimit në zero përqind (figura 2).

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2016, aktiviteti kreditues në eurozonë ka vazhduar rikuperimin, duke u karakterizuar me një rritje vjetore prej 1.9 përqind. Zgjerimi i aktivitetit kreditues është mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës, që ka rezultuar nga përmirësimi i kushteve të kreditimit dhe përshpejtimi i aktivitetit ekonomik. Në këtë periudhë, ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje më të shpejtë të kreditimit prej 2.4 përqind, përderisa kreditë për ndërmarrjet shënuan rritje vjetore prej 0.8 përqind.

Gjatë kësaj periudhe, rritja e të ardhurave në dispozicion në eurozonë mund të ketë ndikuar në rritjen e depozitave të rezidentëve në sektorin bankar në vendet e eurozonës. Rritje më të lartë të depozitave në këtë periudhë shënuan ndërmarrjet (8.0 përqind), pasuar nga depozitat e ekonomive familjare (5.0 përqind).

Figura 2. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së



Burimi: Euribor (2017) dhe BQE (2017)

Aktiviteti ekonomik në Ballkanin Perëndimor gjatë TM2 2017 vazhdoi të përforcohet. Rritja e kërkesës në eurozonë, si partner kryesor tregtar për vendet në Ballkanin Perëndimor, u përkthye në përmirësim të pozicionit të neto eksporteve në disa vende të rajonit. Rritja e eksporteve, së bashku me rritjen e investimeve të huaja dhe konsumit të brendshëm, paraqitën kontribues të rëndësishëm në rritjen mesatare prej 3.3 përqind të BPV-së në Ballkanin Perëndimor në TM2 2017 (tabela 1).

Sikurse edhe në eurozonë, rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare është reflektuar në rritje të shkallës së inflacionit në Ballkanin Perëndimor. Deri në qershor 2017, Serbia u karakterizua me shkallën më të lartë të inflacionit prej 3.4 përqind, pasuar nga Mali i Zi me shkallë prej 2.5 përqind, përderisa

Maqedonia u karakterizua me shkallën më të ulët të inflacionit prej 0.9 përqind.

Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së

Përshkrimi	2013	2014	2015	2016	2017
Bosnja dhe Hercegovina	2.4	1.1	3.2	3.0	3.0
Kosova	3.4	1.2	4.1	3.4	3.7*
Mali i Zi	3.5	1.8	3.2	5.1	3.3
Maqedonia	2.9	3.5	3.7	2.2	3.2
Serbia	2.6	-1.8	0.7	2.5	3.0
Shqipëria	1.0	1.8	2.8	3.4	3.7

\*Parashikim preliminar i BQK-së

Burimi: WEO (2017) dhe vlerësimi i BQK-së

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar, vendet e rajonit u karakterizuan me rritje të aktivitetit kreditues prej 3.9 përqind në tremujorin e dytë të vitit 2017. Rritjen më të lartë e kishte Kosova me 10.0 përqind pasuar nga Mali i Zi me 9.3 përqind, përderisa rënie raportoi Shqipëria (0.1 përqind). Vendet e rajonit raportuan edhe për rritje të depozitave, ku Mali i Zi shënoi rritjen më të lartë të depozitave deri në qershor 2017 (10.9 përqind), pasuar nga Maqedonia (7.6 përqind), përderisa rritjen më të ulët e shënoi Shqipëria (3.7 përqind).

Deri në qershor të vitit 2017, euro është zhvlerësuar kundrejt valutave si lekut shqiptar (2.3 përqind), frankës zvicerane (1.8 përqind), kunës kroate (1.5 përqind), dinarit serb (0.1 përqind) dhe dollarit amerikan (3.0 përqind). Ndërsa është vlerësuar kundrejt sterlines britaneze (10.5 përqind).

## Ekonomia e Kosovës

### Sektori real


Ekonomia e Kosovës, sipas vlerësimeve të ASK-së, ka shënuar rritje të BPV-së reale prej 3.9 përqind në TM1 2017. Kjo rritje e BPV-së është gjeneruar nga rritja e investimeve prej 13.7 përqind si dhe rritja e konsumit prej 1.6 përqind. Në këtë periudhë, neto eksportet vlerësohet të jenë karakterizuar me rritje të deficitit prej 3.3 përqind në terma real. Sa i përket qasjes së prodhimit, rritja vlerësohet të jetë gjeneruar kryesisht nga ndërtimtaria (rritje prej 16.5 përqind), tregtia (7.1 përqind), aktivitetet financiare (12.0 përqind), afarizmi me pasuri të patundshme (5.8 përqind), si dhe industria nxjerrëse dhe industria përpunuese (21.9 përkatësisht 5.3 përqind). Ndërsa, rënie reale vlerësohet të jetë shënuar tek bujqësia (4.0 përqind) dhe administrimi publik (3.9 përqind rënie).

Parashikimet e BQK-së për tërë vitin 2017 sugjerojnë se ekonomia e Kosovës do të karakterizohet me rritje reale prej 3.7 përqind. Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme, ndërsa neto eksportet parashihet të kenë ndikim më të vogël negativ në BPV krahasuar me vitin e kaluar. Konsumi si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, pritet të shënojë rritje reale prej 2.1 përqind, ndërsa investimet parashihet të shënojë rritje reale prej 6.8 përqind. Eksportet neto të mallrave dhe shërbimeve në vitin 2017 pritet të kenë një kontribut më të vogël negativ në BPV krahasuar me vitin e kaluar, supozim i mbështetur kryesisht në parashikimet për rritje të çmimeve të metaleve që priten të ndikojnë në rritjen e vlerës së gjithsej eksporteve.

### Çmimet

Në gjysmën e parë të vitit 2017, niveli i çmimeve në Kosovë është karakterizuar me rritje. IÇK shënoi rritje mesatare prej 1.7 përqind (figura 3).


Figura 3. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2017)

Sa i përket komponentëve të IÇK-së, me rritje u karakterizuan çmimet e rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse (4.9 përqind), transportit (4.7 përqind), pasuar nga çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit (3.1 përqind), veshmbathjes (1.7 përqind).

Figura 4. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2017)

Me rritje prej 1.2 përqind u karakterizuan edhe çmimet e ushqimit, që përfaqësojnë rreth 33.9 përqind të shportës së konsumatorit kosovar.

Në anën tjetër, rënie e çmimeve është shënuar tek rekreacioni dhe kultura (1.4 përqind) si dhe mjetet e komunikimit (0.8 përqind) (figura 4).

Indeksi i çmimeve të importit, në TM2 2017, shënoi rritje prej 4.1 përqind (figura 5).

Figura 5. Indeksat e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit




Burimi: ASK (2017)

Çmimet e produkteve bimore, produkteve minerale dhe metaleve bazë, të cilat janë kategoritë kryesore të indeksit të çmimeve të importit, shënuan rritjen më të lartë (14.5 përkatësisht 10.0 përqind), ndërsa çmimet e letrës dhe artikujt e saj shënuan rënien më të lartë të çmimeve (4.8 përqind) (figura 6).

Indeksi i çmimeve të prodhimit u karakterizua me rënie prej 0.5 përqind. Në këtë periudhë, me rritje të çmimeve u karakterizuan nxjerrja e xehes së metalit, energjia elektrike, prodhimi i mobileve, etj.


Figura 6. Lëvizja e çmimeve të importit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2017)

Ndërsa, me rënie të çmimeve u karakterizuan kryesisht prodhimi i metaleve, prodhimi i drurit, prodhimi i lëkurës, etj. (figura 7).

Figura 7. Lëvizja e çmimeve të prodhimit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2017)

### Regjistri i bizneseve

Sa i përket regjistrimit të bizneseve, deri në qershor 2017 është shënuar numër më i vogël i ndërmarrjeve të regjistruara dhe numër më i vogël i ndërmarrjeve të mbyllura. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte 5,087 apo 610 ndërmarrje më pak se sa në periudhën e njëjtët të vitit 2016, ndërsa u mbyllën 890 ndërmarrje apo 494 ndërmarrje më pak (figura 8).




Figura 8. Regjistri i bizneseve, jo kumulative



Burimi: ASK (2017)

Numri më i madh i ndërmarrjeve të reja të regjistruara vazhdon të jetë i koncentruar në sektorin e tregtisë me 1,422 ndërmarrje të reja, pasuar nga sektori i hotelarisë me 539 ndërmarrje, sektori i prodhimit me 499 ndërmarrje, etj. (figura 9).

Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2017)

Krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2016, në shumicën e sektorëve është shënuar numër më i vogël i ndërmarrjeve të regjistruara. Në sektorin e prodhimit është shënuar rënia më e madhe e ndërmarrjeve të reja të regjistruara prej 178 ndërmarrje më pak, pasuar nga sektori i tregtisë që u karakterizua me 177 ndërmarrje më pak të regjistruara. Sektorët që shënuan numër më të madh

të ndërmarrjeve të regjistruara ishin sektori i aktiviteteve profesionale dhe sektori i ndërtimtarisë (24 përkatësisht 15 ndërmarrje më shumë).

### Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore<sup>1</sup> deri në qershor 2017 arritën vlerën neto prej 753.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore rreth 4.1 përqind. Në të njëjtën periudhë, shpenzimet buxhetore<sup>2</sup> arritën vlerën prej 751.1 milionë euro që paraqet një rritje vjetore rreth 6.9 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi bilanc primar buxhetor prej 2.8 milionë euro krahasuar me bilancin prej 21.6 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2016.

Sa i përket llojit të tatimeve, vërehet rritje më e lartë e të hyrave tatimore jo-direkte të cilat arritën vlerën prej 573.6 milionë euro (5.1 përqind rritje), pasuar nga të hyrat tatimore direkte të cilat arritën vlerën prej 119.0 milionë euro (3.9 përqind rritje). Rritje edhe më e lartë e të hyrave buxhetore prej 9.5 përqind është shënuar tek të hyrat jo-tatimore, të cilat arritën vlerën prej 90.9 milionë euro.

Sa i përket shpenzimeve, pothuajse të gjitha kategoritë u karakterizuan me rritje. Shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje shënuan një rritje të lehtë prej 0.6 përqind dhe arritën vlerën 274.2 milionë euro. Mallrat dhe shërbimet (përfshihen edhe shpenzimet komunale) shënuan rritje prej 8.2 përqind dhe arritën vlerën 94.9 milionë euro. Subvencionet dhe transferet shënuan rritje për 9.0 përqind dhe

<sup>1</sup> Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

<sup>2</sup> Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN, kthimet nga fondet e depozitave, si dhe kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike trajtohet si zvogëlim i shpenzimeve.

arritën vlerën 230.9 milionë euro. Rritjen më të lartë e shënuan investimet kapitale të cilat arritën vlerën prej 159.3 milionë euro që janë për 18.7 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.


Borxhi publik arriti në 947.5 milionë euro në qershor 2017, që tregon për një rritje prej 15.3 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në rreth 15.5 përqind nga 13.8 përqind. Kjo rritje e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të jashtëm prej 15.5 përqind (vlera e të cilit ka arritur në 443.0 milionë euro) dhe borxhit të brendshëm prej 15.1 përqind (504.5 milionë euro).

### Sektori i Jashtëm

Deri në qershor 2017, deficitin e llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 372.4 milionë euro, krahasuar me deficitin prej 387.4 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ky deficit i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale i atribuohet kryesisht deficitit në llogarinë e mallrave. Në anën tjetër, bilancet pozitive të shërbimeve, llogarisë së të ardhurave parësore dhe llogarisë së të ardhurave dytësore shënuan rritje.

Deficiti në tregtinë e mallrave u karakterizua me një rritje vjetore prej 6.2 përqind deri në qershor 2017. Eksporti i mallrave arriti vlerën prej 179.3 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 17.7 përqind (figura 10).<sup>3</sup>


Figura 10. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK (2017)

Rritja e vlerës së eksportit të mallrave gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rritjes së eksportit të produkteve minerale, metaleve bazë, ushqimeve të përgatitura, pijeve, perimeve, etj. Në anën tjetër, me rënie u karakterizua eksporti i tekstilit dhe artikujt e tekstilit si dhe lëkura dhe artikujt e sajë (figura 11).

Figura 11. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2017)

Vlera e gjithsej mallrave të importuara arriti në 1.4 miliardë euro deri në qershor 2017, që paraqet një rritje vjetore prej 7.6 përqind. Rritja e importit ishte kryesisht rezultat i rritjes së produkteve minerale, ku përfshihet importi i naftës dhe derivateve të saj, çmimet e të cilave janë rritur në tregjet ndërkombëtare. Me rritje është karakterizuar edhe

<sup>3</sup> Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

importi i mjeteve transportuese, makinerive, ushqimeve të përgatitura, pijeve, etj. Në anën tjetër, importi plastikës, artikujve të gurit, qeramikës, qelqit, etj. shënuan rënie (figura 12). Në qershor 2017, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte ishte 12.8 përqind (11.7 përqind në qershor të vitit 2016).

Figura 12. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2017)


Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 165.1 milionë euro deri në qershor 2017, një rritje prej 37.3 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016. Vlëra e gjithsej shërbimeve të eksportuara shënoi rritje vjetore prej 8.0 përqind, duke arritur në 350.7 milionë euro, ndërsa vlëra e shërbimeve të importuara shënoi rënie prej 9.3 përqind dhe arriti në 185.6 milionë euro.

Në kuadër të eksportit të shërbimeve, shërbimet e udhëtimit u karakterizuan me rritje, ndërsa shërbimet e ndërtimit shënuan rënie. Sa i përket importit të shërbimeve, shërbimet e udhëtimit dhe shërbimet e transportit shënuan rënie ndërsa shërbimet e kompjuterike shënuan rritje.

Llogaria e të ardhurave parësore u karakterizua me rritje prej 22.1 përqind. Bilanci i të ardhurave nga

kompensimi i punonjësve<sup>4</sup> shënoi rritje për 11.2 përqind, ndërsa bilanci i të ardhurave nga investimet u zvogëlua për 1.1 përqind. Në të njëjtën periudhë, bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje për 4.6 përqind, që i atribuohet nivelit më të lartë të remitencave. Remitencat e pranura në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, arritën vlerën prej 359.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.8 përqind (figura 13).

Figura 13. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2017)


Remitencat që pranohen në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 39.2 përqind përkatësisht 22.6 përqind të gjithsej remitencave të pranura në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 7.3 përqind e gjithsej remitencave të pranura në Kosovë.

Investimet e Huaja Direkte (IHD) të pranura në Kosovë arritën vlerën prej 139.2 milionë euro deri në qershor 2017, që paraqet një rritje prej 64.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në

<sup>4</sup> Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të pranura nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshinë punëtorët sezonal apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qëndrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

kuadër të strukturës së IHD-ve, me rritje u karakterizua kapitali dhe fondi i investimeve në aksione ndërsa investimet në instrumente të borxhit shënuan rënie (figura 14).

Figura 14. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro




Burimi: BQK (2017)

Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, që përbën rreth 85.0 përqind të gjithsej IHD-ve, arriti vlerën prej 118.3 milionë euro dhe shënoi rritje prej 88.3 përqind. IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit arritën vlerën prej 20.9 milionë euro, një rënie prej 4.8 përqind. Rritje më e lartë e IHD-ve u shënuar në sektorin e shërbimeve financiare dhe në ndërtimtari (32.5 përkatësisht 13.9 milionë euro më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar), përderisa sektori i tregtisë u karakterizuan me rënie vjetore prej 1.0 përqind.

### Sistemi Financiar

Vlera e gjithsej asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 5.56 miliardë euro në qershor 2017, që paraqet një rritje vjetore prej 9.6 përqind (figura 15).

Figura 15. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës



Në zgjerimin e asetëve të sistemit financiar kontributin kryesor vazhdojnë ta kenë rritja e sektorit bankar dhe atij pensional, përderisa kontributi i institucioneve tjera ishte mjaftë i ulët.

### Sektori Bankar


#### Asetet

Në qershor 2017, asetet e sektorit bankar shënuan rritje vjetore prej 7.0 përqind, duke arritur në 3.67 miliardë euro (figura 16). Rritja e asetëve të sektorit bankar vazhdon të mbështetet kryesisht në përsheptimin e rritjes së aktivitetit kreditues.

Zgjerimi i aktivitetit kreditues të sektorit bankar vazhdon të mbështetet nga ecuria e depozitave, rritja e të cilave paraqet burimin kryesor të financimit të kreditimit në vend.

Në qershor 2017, stoku i letrave me vlerë i sektorit bankar shënoi ngadalësim të rritjes në 1.4 përqind, nga 2.1 përqind sa ishte në vitin e kaluar.

Figura 16. Struktura e asetëve të sektorit bankar



Ngadalësimi i rritjes në këtë kategori kryesisht i atribuohet rënies së investimeve në sektorin e jashtëm. Në qershor 2017, investimet në letrat me vlerë të qeverive të huaja shënuan rënie vjetore prej 7.1 përqind (10.1 përqind rritje në qershor 2016). Në të njëjtën periudhë, investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës shënuan rritje vjetore prej 11.7 përqind (rënie prej 6.2 përqind në qershor 2016). Ngadalësimi i rritjes së investimeve në letrat me vlerë mund t'i atribuohet deri në një masë ndryshimit të strategjisë investuese të bankave, duke pas parasysh rënien e normës mesatare të interesit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe normave përgjithësisht të ulëta të interesit në tregjet e jashtme. Në anën tjetër, përmirësimi i vazhdueshëm i portfolios kreditore dhe kthimi më i lartë nga investimet në kredi, ka ndikuar që bankat të vazhdojnë të zhvendosin investimet e tyre drejtë kreditimit edhe në tremujorin e dytë të vitit 2017, që ka vazhduar të përcjellë trend të përsheptuar të rritjes.


**Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në shënoi rënie vjetore prej 1.5 përqind krahasuar me rritjen në vitin paraprak prej 9.0 përqind.**

Aplikimi i normave negative të interesit për rezervat e bankave mbi nivelin e detyrueshëm prej 10 përqind, si dhe zhvendosja e mjeteve në portofolin kreditor, mund të kenë ndikuar në rënien e kësaj kategorie.

### Kreditë

**Kreditë e sektorit bankar vazhduan ecurinë pozitive të rritjes për të katërtin vit me radhë, duke shënuar një rritje vjetore prej 10.0 përqind në qershor 2017 (figura 17).** Vlera e gjithsej kredive arriti në 2.39 miliardë euro në periudhën raportuese, kryesisht si rezultat i ofertës së lehtësuar kredituese.

Figura 17. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave, në përqindje




**Stoku i kredive ndaj ekonomive familjare vazhdon të jetë kategoria me normën më të lartë të rritjes në gjashtë vitet e fundit.** Në qershor 2017, kjo kategori shënoi rritje vjetore prej 12.5 përqind (figura 18). Ndërsa, kreditë e reja të lëshuara për ekonomitë familjare u karakterizuan me ngadalësim të rritjes. Këto kredi shënuan rritje vjetore prej 2.3 përqind në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 (18.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2016). Ngadalësimi i rritjes së kredive të reja për

ekonomitë familjare u ndikuar kryesisht nga zvogëlimi i portofolit të kredive të reja konsumuese.

**Kreditë ndaj ndërmarrjeve përsheptuan ritmin e rritjes në periudhën raportuese (figura 18).** Kreditë e reja të lëshuara për ndërmarrje shënuan rritje të theksuar gjatë kësaj periudhe (29.5 përqind) kundrejt rënies vjetore me të cilën u karakterizuan në vitin paraprak (17.4 përqind). Rritja e theksuar e kredive të reja për ndërmarrje ishte kryesisht rezultat i rritjes së kredive të reja investuese dhe jo-investuese, kryesisht të destinuara për sektorin e industrisë dhe të shërbimeve.

Figura 18. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare




Burimi: BQK (2017)

Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike vazhdon të mbetet e dominuar nga kreditë e destinuara për sektorin e tregtisë. Krahasuar me periudhën paraprake, kreditë për sektorin e shërbimeve tjera rritën pjesëmarrjen për 2.7 pikë përqindje, kurse kreditë e destinuara për shërbimet financiare u tkurrën për 3.1 pikë përqindje. (figura 19).

**Në qershor 2017, kreditimi i sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë shënoi rritje (figura 20).**


Figura 19. Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje (qershor 2017)



Burimi: BQK (2017)

Rritje vjetore të kreditimit shënuan veçanërisht sektori i ndërtimtarisë, prodhimtarisë dhe i tregtisë, që së bashku përfaqësojnë 71.8 përqind të gjithsej kreditimit për ndërmarrjet. Kurse, me rënie u karakterizuan sektori i shërbimeve financiare, energjetikës dhe bujqësisë, që së bashku përfaqësojnë rreth 9.0 përqind të gjithsej kreditimit të industrisë.

Figura 20. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2017)

Kreditë e reja ndaj ndërmarrjeve që në vitin e kaluar u karakterizuan me rënie, në gjysmën e parë të vitit 2017 shënuan rritje të theksuar. Kontributin kryesor në rritjen e kredive të reja ndaj ndërmarrjeve kishin kreditë me karakter jo-investues (46.0 përqind),

pasuar nga kreditë investuese (15.3 përqind). Sipas sektorëve ekonomik, kreditë e reja ndaj sektorit të industrisë dhe shërbimeve shënuan rritje të theksuar vjetore prej 46.1 përkatësisht 21.4 përqind deri në qershor 2017. Kurse, kreditë e reja ndaj sektorit të bujqësisë për të dytin vit me radhë vazhduan trendin rënës.

*Rritja e aktivitetit të sektorit bankar në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2017 u mbështetet nga zgjerimi i portofolit kreditor, në prani të përmirësimit të ofertës kreditore. Sa i përket strukturës së sektorëve ekonomik, ajo vazhdoi të mbetet e ngjashme me periudhat paraprake. Rritje vjetore të theksuar të kreditimit gjatë kësaj periudhe kishin sektori i ndërtimitarisë, prodhimtarisë dhe i tregtisë.*

### Detyrimet dhe Burimet Vetanake


Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, që përbëjnë 78.7 përqind të gjithsej detyrimeve dhe burimeve vetanake. Depozitat vazhdojnë të jenë burimi kryesor i financimit të aktiviteteve të sektorit bankar. **Kategoria e burimeve vetanake të sektorit bankar u karakterizua me rritje vjetore prej 13.4 përqind**, kryesisht si rezultat i rritjes së vlerës së fitimit aktual dhe fitimit të mbajtur në 45.6 përkatësisht 129.6 milionë euro (37.7 përkatësisht 88.2 milionë euro në qershor 2016).

### Depozitat

Depozitat në sektorin bankar të Kosovës shënuan rritje vjetore prej 7.2 përqind, ritëm ky i përshpejtuar krahasuar me periudhat paraprake (4.6 përqind në qershor 2016). Vlera e

gjithsej depozitave, deri në qershor 2017 arriti në 2.89 miliardë euro (figura 21).


Figura 21. Depozitat, në milionë euro



Burimi: BQK (2017)

Niveli i depozitave në sektorin bankar reflekton ecurinë e depozitave të ekonomive familjare, të cilat dominojnë strukturën e gjithsej depozitave dhe në periudhën raportuese shënuan rritje vjetore prej 5.4 përqind (figura 22).

Figura 22. Struktura e depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2017)

Në gjysmën e parë të vitit, depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje të përshpejtuar vjetore prej 14.1 përqind, që mund të jetë ndikuar nga rritja e normës mesatare të interesit në depozitat për ndërmarrjet. Sipas kategorive të depozitave,


depozitat e transferueshme vazhduan të rrisin pjesëmarrjen në strukturën e gjithsej depozitave, por me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me periudhën e njëjtë të dy viteve paraprake. Në anën tjetër, depozitat e kursimit dhe ato të afatizuara zvogëluan pjesëmarrjen, që mund t'i atribuohet deri në një masë normës së ulët të interesit që po mbizotëron në depozita.

*Pas dy viteve të ngadalësimit të rritjes, depozitat në sektorin bankar në qershor 2017 përshpejtuan ritmin e rritjes. Depozitat e transferueshme vazhdojnë të dominojnë strukturën e depozitave, përderisa të afatizuarat dhe të kursimit zvogëluan pjesëmarrjen në gjithsej depozitat.*

### Normat e Interesit

Dallimi në mes të normës mesatare të interesit në kredi dhe asaj në depozita u ngushtua në 5.7 përqind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (6.2 përqind në qershor 2016).

Figura 23. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK (2017)


Norma mesatare e interesit në kredi në qershor 2017 u zvogëluar në 6.8 përqind përderisa norma mesatare e interesit në depozita shënoi rritje të lehtë në 1.1 përqind (figura 23).

### Normat e interesit në kredi

Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në qershor 2017 qëndroi në 6.6 përqind nga 6.7 përqind sa ishte në qershor 2016 (figura 24).

Në kuadër të kësaj kategorie, normat e interesit në kreditë jo investuese vazhduan trendin rënës, kurse në kreditë investuese shënuan rritje të lehtë. Edhe kategoritë tjera të normave të interesit siç janë ‘mbitërheqjet’, ‘linjat e ndryshme kreditore’ dhe ato me ‘kushte favorizuese’, gjatë kësaj periudhe u karakterizuan me rënie të lehtë krahasuar me periudhën paraprake.

Figura 24. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve




Burimi: BQK (2017)

Normat e interesit në të gjithë sektorët ekonomik, përveç ‘sektorëve tjerë’, shënuan rënie. Norma e interesit në sektorin e bujqësisë shënoi rënie më të theksuar, për dallim nga sektori i industrisë dhe shërbimeve që patën një rënie të lehtë (figura 25).

Normat e interesit në kreditë për ekonomitë familjare vazhduan trendin rënës në 7.1 përqind (7.8 përqind në qershor 2016).



Figura 25. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2017)

Në kuadër të kredive për ekonomitë familjare, norma mesatare e interesit për kreditë konsumuese dhe për ato hipotekare vazhduan të ndjekin trend rënës, përderisa ato me kushte favorizuese shënuan rritje.

### Normat e interesit në depozita

Norma mesatare e interesit në gjithsej depozitat u rrit lehtësisht kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak (figura 26).

Figura 26. Norma mesatare e interesit në depozita




Burimi: BQK (2017)

Në depozitat e ndërmarrjeve, norma mesatare e interesit arriti në 1.7 përqind nga 1.5 sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Më konkretisht, rritje shënuan normat e interesit në

depozitat e kursimit dhe ato të afatizuara të ndërmarrjeve prej 0.3 përkatësisht 0.1 pikë përqindje (figura 27).


Figura 27. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje, sipas kategorive



Burimi: BQK (2017)

Po ashtu, norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare shënoi rritje për 0.1 pikë përqindje krahasuar me periudhën paraprake, në 0.9 përqind në qershor 2017.

Figura 28. Norma mesatare e interesit në depozitat për ekonomitë familjare, sipas kategorive



Burimi: BQK (2017)


Norma mesatare e interesit në depozitat e transferueshme dhe të kursimit shënoi rënie të lehtë, përderisa norma mesatare e interesit në depozitat e afatizuara shënoi rritje të lehtë (figura 28).

### Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar u karakterizua me rritje të profitit, si rezultat i rritjes së të hyrave dhe rënies së shpenzimeve të sektorit.

Vlera e profitit të realizuar deri në qershor 2017 ishte 45.6 milionë euro, që përbën një rritje vjetore prej 20.8 përqind (figura 29).

Figura 29. Profiti neto i sektorit bankar, në milionë euro




Burimi: BQK (2017)

**Të hyrat e sektorit bankar ndërprejnë trendin rënës, trend që e karakterizoi sektorin gjatë katër viteve të kaluara (figura 30).** Deri në qershor 2017, vlera e të hyrave arriti në 119.7 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 5.2 përqind. Rritja e të hyrave kryesisht i atribuohet rritjes së të hyrave nga jo-interesi, më saktësisht të hyrave tjera operative dhe atyre nga tarifat dhe komisionet. Ndërsa, të hyrat nga interesi patën rënie të lehtë, veçanërisht të hyrat nga interesi për kredi, si rezultat i zvogëlimit të normës mesatare të interesit në kredi.

**Vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar arriti në 74.1 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 2.5 përqind (figura 30).**

Figura 30. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar




Burimi: BQK (2017)

Zvogëlimi i gjithsej shpenzimeve ishte si rezultat i rënies së shpenzimeve nga jo-interesi dhe atyre të interesit në masë më të vogël. Në kuadër të kategorisë së shpenzimeve të jo-interesit, rënia ishte si rezultat i zvogëlimit të provizionet për humbje nga kreditë. Rënia e kategorisë së shpenzimeve të interesit ishte si rezultat i rënies së shpenzimeve për interesat në depozitat e klientëve.

**Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit u përmirësua,** duke rënë në 61.9 përqind, si rezultat i përmirësimit të performancës së bankave në arkëtimin e të hyrave dhe menaxhimin më të mirë të shpenzimeve (figura 30).

**Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) si dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) u karakterizuan me rritje gjatë kësaj periudhe kundrejt vitit 2016.** Rritja e shënuar në këta dy indikator kryesisht i atribuohet analizimit të fitimit (figura 31).


Figura 31. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



### Treguesit e shëndetit financiar

Deri në qershor 2017, sektori bankar regjistroi rënie të kredive joperformuese dhe përmirësim të mbulueshmërisë së tyre me provizione. Niveli i kredive joperformuese shënoi rënie në 3.9 përqind, një shkallë e ulët krahasuar me vendet në Ballkanin Perëndimor dhe vendet në eurozonë (figura 32).

Figura 32. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve




Për më tepër, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione shënoi rritje në 136.6 përqind.

Sektori bankar vazhdon të ketë nivel të lartë të kapitalizimit, me treguesin e mjaftueshmërisë

së kapitalit në 18.1 përqind në qershor 2017. Treguesi kyç i likuiditetit, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra, shënoi rënie në krahasim me vitin paraprak.

Figura 33. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës




Në këtë zhvillim ndikoi në një rritje të detyrimeve afatshkurtra, që reflekton pjesëmarrjen më të lartë të depozitave të transferueshme në kuadër të gjithsej depozitave, si dhe rënies së mjeteve likuide, si pasojë e zhvendosjes së aseteve likuide në asete afatgjata. Megjithatë, sektori bankar vazhdon të shfaqë pozicion të kënaqshëm të likuiditetit (figura 33).

Deri në qershor 2017, sektori bankar shënoi rritje të theksuar të profitit si rezultat i rritjes së të hyrave dhe zvogëlimit të shpenzimeve. Niveli i kredive joperformuese është mjaftë i ulët dhe mbulueshmëria e tyre me provizione mjaftë e lartë. Po ashtu, sektori bankar vijon të ketë nivel të lartë të kapitalizimit dhe pozitë të kënaqshme të nivelit të likuiditetit.

## Sektori pensional

Deri në qershor 2017, sektori pensional shënoi rritje të përshpejtuar vjetore të aseteve prej 15.8 përqind. Vlera e përgjithshme e aseteve të sektorit pensional arriti në 1.54 miliard euro, që paraqet sektorin e dytë më të madh në sistemin financiar me 27.7 përqind të aseteve (figura 34). Rritja e aseteve të sektorit pensional kryesisht mund t'i atribuohet rritjes së kontributeve të reja dhe kthimit në investime gjatë kësaj periudhe.

Vlera e arkëtimeve të reja arriti në 77.2 milionë euro, krahasuar me vlerën prej 74.3 milionë euro në qershor 2016. Vlera e arkëtimeve të reja të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK-së) arriti në 77.0 milionë euro, ndërsa ajo e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP-së) arriti në 244.3 mijë euro.




Burimi: BQK (2017)

Sektori pensional rriti dukshëm kthimin në investime në 56.5 milionë euro, për dallim nga kthimi prej 33.6 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. FKPK realizoi kthim pozitiv në investime prej 56.3 milionë euro, ndërsa FSKP 227.8 mijë euro. Përmirësimi i treguesve të

zhvillimit ekonomik dhe fitimeve të korporatave në BE, SHBA, Mbretërinë e Bashkuar dhe Japoni ndikuan që indekset kryesore të kontribuojnë në rritje të theksuar të kthimit në investime të FKPK-së. Për më tepër, edhe rënia e rrezikut politik në BE ndikoi në kthimin pozitiv në investime.

FKPK, që përbën 99.5 përqind të aseteve të sektorit pensional, ndërroi strategjinë investive në krahasim me vitin e kaluar, duke rritur investimet jashtë vendit krahas zvogëlimit të investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Investimet e fondit jashtë vendit arritën vlerën prej 1.3 miliardë euro (1.1 miliardë euro në qershor 2016), për dallim nga investimet në letrat me vlerë të Kosovës që shënuan rënie në 68.8 milionë euro (103.3 milionë euro në qershor 2016) (figura 35).

Figura 35. Investimet e FKPK-së, milionë euro



Burimi: FKPK (2017)


Sektori pensional deri në qershor 2017 shënoi rritje të përshpejtuar vjetore të aseteve. Kthimi pozitiv në investime si dhe rritja e kontributeve të reja ishin dy faktorët kryesorë që ndikuan në këtë rritje. Sektori i orientoi investimet në fondet e përbashkëta investuese jashtë vendit kundrejt letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

## Sektori i sigurimeve

**Sektori i sigurimeve, që përfaqëson rreth 3.0 përqind të gjithëj aseteve të sistemit financiar, në qershor 2017 shënoi rritje vjetore më të ngadalësuar prej 3.8 përqind** (figura 36). Një ndër kontribuesit kryesor në rritjen e aseteve të sektorit të sigurimeve ishte rritja e parave të gatshme të mbajtura në bankat komerciale, që kanë pjesëmarrjen më të madhe në strukturën e aseteve të kompanive të sigurimit.

Sigurimet jo-jetë, të cilat përfaqësojnë pjesën më të madhe të sektorit me 90.0 përqind të gjithëj aseteve, shënuan rritje vjetore prej 3.3 përqind. Ndërsa, pjesa e mbetur e sektorit e përfaqësuar nga sigurimet 'jetë', shënuan rritje vjetore prej 8.4 përqind.

Figura 36. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK (2017)


**Deri në qershor 2017, vlera e primeve të shkruara nga kompanitë e sigurimeve arritën vlerën prej 42.1 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.5 përqind.** Struktura e primeve të shkruara kryesohet nga primet e sigurimit jo-jetë, të cilat përfaqësojnë 96.9 përqind të gjithëj primeve të shkruara. Vlera e realizuar e primeve të shkruara nga sigurimi jo-jetë arriti në 40.8 milionë

euro në qershor 2017, që tregon për një rritje vjetore prej 2.7 përqind. Ndërsa, vlera e primeve të shkruara nga sigurimi jetë arriti vlerën 1.3 milionë euro, duke shënuar një rënie vjetore prej 2.9 përqind.

**Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e kompanive të sigurimit dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), arritën në 22.6 milionë euro në qershor 2017 (18.2 milionë euro në qershor 2016), që paraqet një rritje të theksuar vjetore prej 24.4 përqind.**

Rritja më e vogël e primeve të pranuar gjatë kësaj periudhe krahas rritjes më të lartë të dëmeve të paguara ndikoi në rritjen e raportit të gjithëj dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara, që nënkupton ngarkesë më të lartë për kompanitë e sigurimeve ngase më shumë se gjysma e të ardhurave nga primet i dedikohet pagesës së dëmeve të ndodhura (figura 37).

Figura 37. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK (2017)

## **Performanca e sektorit të sigurimeve**

**Deri në qershor 2017 sektori i sigurimeve u karakterizua me performancë pozitive për dallim nga periudha e njëjtë e vitit paraprak.**

Të hyrat neto nga primet të sektorit të sigurimeve në qershor 2017 arritën vlerën prej 37.1 milionë euro, përderisa shpenzimet shënuan rënie në 20.9 milionë euro. Rënia e shpenzimeve u reflektua në rritjen e profitit të regjistruar nga sektori i sigurimeve në 2.0 milionë euro deri në qershor 2017, nga humbja prej 11.5 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.<sup>5</sup> Rritja e profitit kryesisht i atribuohet rritjes së shënuar në kuadër të sigurimit 'jo-jetë' (fitim prej 1.9 milionë euro), përderisa performanca pozitive financiare e sigurimit 'jetë' ishte 158.8 mijë euro.

**Rritja vjetore e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj prej 6.6 përqind, krahas rritjes më të lartë prej 10.7 përqind të rezervave teknike të sektorit të sigurimeve, u reflektuan në përkeqësimin e nivelit të likuiditetit të sektorit.** Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave zbriti në 94.2 përqind në qershor 2017 (97.8 në qershor 2016), po ashtu raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve u zvogëluar në 85.2 përqind (86.3 në qershor 2016).

---

*Sektori i sigurimeve në qershor 2017 u karakterizua me rritje të aseteve. Performanca financiare e këtij sektori u përmirësua, duke u karakterizuar me rritje të të hyrave neto dhe të profitit, si dhe rënie të shpenzimeve.*


---

## **Sektori mikrofinanciar**

### **Asetet**

**Deri në tremujorin e dytë të vitit 2017, asetet e sektorit mikrofinanciar arritën në 169.2 milionë**

**euro, duke shënuar rritje të theksuar vjetore prej 24.5 përqind (figura 38).**



Burimi: BQK (2017)

Kontribuues kryesor në rritjen e aseteve të sektorit ishte rritja e kredive bruto, kryesisht të financuara nga huamarrjet në sektorin e jashtëm, e që dominojnë strukturën e përgjithshme të aseteve të sektorit mikrofinanciar (76.1 përqind).


### **Kreditë**

**Aktiviteti kreditor i sektorit mikrofinanciar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017 u karakterizua me rritje të përsheptuar të vlerës së kredive prej 31.9 përqind (figura 39).**

Ekonomitë familjare, që kanë një pjesëmarrje prej 64.9 përqind në gjithsej kreditë e sektorit, u karakterizuan me rritje vjetore prej 27.8 përqind. Gjithashtu, kreditë ndaj ndërmarrjeve që përfaqësojnë 35.1 përqind të gjithsej kredive të sektorit, shënuan një rritje vjetore prej 40.2 përqind.

<sup>5</sup> Bazuar në të dhënat e paaudituar.


Figura 39. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve dhe rritja vjetore e kredive



Burimi: BQK (2017)

Sa i përket stokut të kredive ndaj sektorëve ekonomik, kategoria e ‘sektorëve tjerë’ shënoi rritjen më të lartë vjetore, pasuar nga ndërtimtaria dhe industria (figura 40).

Figura 40. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2017)

### Lizingjet

Deri në qershor 2017, lizingjet shënuan rritje vjetore prej 8.9 përqind, kundrejt rënies së shënuar në vitin paraprak prej 4.1 përqind (figura 41).

Figura 41. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2017)

Në rritjen e lizingjeve kontribuoi rritja e ‘lizingjeve tjera’ dhe lizingjeve hipotekare, që shënuan rritje vjetore prej 22.6 përkatësisht 4.4 përqind.

### Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar në qershor 2017 u rrit lehtësisht në 22.1 përqind.


Figura 42. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2017)

Norma e interesit për kreditë ndaj ekonomive familjare u rrit për 0.9 pikë përqindje, ndërsa norma e interesit për kreditë ndaj ndërmarrjeve u karakterizua me rënie prej 0.2 pikë përqind (figura 42).

Figura 43. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2017)

Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i shërbimeve rezulton të ketë normën më të ulët të interesit në kredi. Ndërsa, sektori i industrisë, përkundër rënies, vazhdon të ketë normën më të lartë të interesit në kredi (figura 43).

### Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar realizoi profit në vlerë prej 3.9 milionë euro deri në qershor 2017, krahasuar me profitin në vlerë prej 1.6 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Figura 44. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2017)

Rritja më e lartë e të hyrave (kryesisht e atyre nga interesi) krahas rritjes më të ulët të shpenzimeve ndikoi në profit më të lartë të realizuar në këtë periudhë (figura 44).

Si rezultat i performancës pozitive financiare gjatë tremujorit të parë të vitit 2017, treguesit e profitabilitetit shënuan përmirësim (figura 45).


Figura 45. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



\*Për vitin 2017 profiti është anualizuar me performancën deri në Qershor 2017  
Burimi: BQK (2017)

Niveli i kredive joperformuese në raport me gjithsej kreditë deri në qershor 2017 u zvogëlua për 1.9 pikë përqindje kundrejt vitit paraprak duke rënë në 2.5 përqind, nivel ky më i ulët në vitet e fundit (figura 46).

Figura 46. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore



Burimi: BQK (2017)



Për më tepër, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizioneve shënoi rritje të theksuar në 202.6 përqind, ndikuar kryesisht nga rënia e vlerës së kredive joperformuese (figura 46).

*Sektori mikrofinanciar u karakterizua me përshpejtim të rritjes së asetëve deri në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017. Gjithsej kreditë vazhduan të shënojnë rritje, përderisa norma mesatare e interesit ndërroi kahjen e trendit rënës dhe u rrit lehtësisht. Sektori shënoi rritje të theksuar të profitit, përderisa edhe cilësia e portofolit kreditor u përmirësua dukshëm.*

### Tregu i letrave me vlerë

Sipas kalendarit të publikuar nga Ministria e Financave, deri në qershor 2017 numri i ankandëve për emetimin e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës arriti në 10. Vlera e shpallur në ankande ishte 220.0 milionë euro.

Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, numri dhe vlera e emetuar e bonove të thesari u zvogëluar, përderisa numri dhe vlera e fletë-obligacioneve të emetuara u rrit. Ndërsa, deri në qershor 2017 si numri ashtu edhe vlera e emetuar e bonove të thesarit dhe fletë-obligacioneve është ndarë në mënyrë të barabartë (tabela 2).

**Tabela 2. Numri dhe vlera e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës**


Periudha	Numri i bonove të thesarit	Vlera e shpallur bonove të thesarit	Numri i fletëobligacioneve	Vlera e shpallur e fletëobligacioneve
Janar-Qershor 2014	9	200.0	2	22.0
Janar-Qershor 2015	8	160.0	3	55.0
Janar-Qershor 2016	7	160.0	4	90.0
Janar-Qershor 2017	5	110.0	5	110.0

Burimi: MF (2017)

Sipas afatit të maturimit, struktura e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës vazhdon të tregojë tendencë të zhvendosjes nga letrat me vlerë me

maturitet afatshkurtër (364 ditë) në letra me vlerë me maturitet afatgjatë (2 vite).


Figura 47. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: BQK (2017)

Kategoria kryesore në strukturën e letrave me vlerë vazhdon të mbetet ajo e bonove të thesarit me afat maturimi 364 ditë, pasuar nga fletë obligacionet me afat maturimi dy vite, e cila ishte kategoria me rritjen më të madhe deri në qershor 2017 (figura 47).

Figura 48. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2017)

Shuma e ofertuar nga pjesëmarrësit tejkaloi shumë e shpallur në ankande nga Ministria e Financave për 1.71 herë (2.21 herë në qershor 2016). Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017, është vënë re një rënie e ofertës dhe njëkohësisht rënie e emetimit të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

### **Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:**

BQK (2017): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 19 TM2 2017, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

### **Referencat:**

BQK (2017):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <http://bqk-kos.org/?id=107>

ASK (2017):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-)
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-)
- c) Indeksi i çmimeve të importit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-)
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat ë tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2017): Metal Prices database.

FAOUN (2017): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2017): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2017): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

## Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Qershor 2016	Qershor 2017
Sektori real 1/		
PBB (në milionë euro)	-	-
Çmimet (mesatarja vjetore)	0.0%	1.7%
Çmimet (fondi i periudhës)	-0.3%	1.7%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	724.0	753.9
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	702.3	751.1
Bilanci primar (në milionë euro)	21.6	2.8
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	5,074.8	5,564.4
prej të cilave: Bankat	3,432.1	3,671.2
Kredi	2,173.5	2,390.5
Depozita	2,692.8	2,887.8
Norma e interesit në kredi, fundi i periudhës	7.2	6.8
Norma e interesit në depozita, fundi i periudhës	1.0	1.1
Hendeku i normës së interesit	6.2	5.7
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-387.4	-372.4
prej të cilave: remitencat e pranuar	321.8	359.9
Llogaria financiare	-115.6	-202.0
Investimet e huaj direkte në Kosovë	84.8	139.2
Investimet portfolio, net	120.7	-81.1
Investimet tjera, net	-200.6	-95.4
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve, net*	10.7	27.4
Asetet	4,458.8	4,799.7
Detyrimet	4,448.1	4,772.4
Borxhi i jashtëm, gjithsej	1,927.7	2,108.2
Borxhi i jashtëm privat	1,469.6	1,574.7
Borxhi i jashtëm publik	458.1	533.6

Burimi:

1/ ASK (2017).

2/ MF (2017).

3/ BQK (2017).

\* Për PNI dhe borxhin e jashtëm të dhënat e fundit janë deri në mars 2017.

